



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2959 Prot

Shkodër, më 22.09.2025

V E N D I M

Nr. 243 Datë 22.09.2025

**"PËR CAKTIMIN ME KOMANDIM TË ADMINISTRATORIT TË USH-SË NJËKOHËSISHT
EDHE NËPUNËS AUTORIZUES TË USH-së"**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të larta në Republikën e Shqipërisë", Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar); Ligjit nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", VKM nr. 75, datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Udhëzimit nr.2 datë 24.01.2025 të MFE "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025", Udhëzimit të Përbashkët nr. 20, datë 20.9.2019 "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor". Bordi i Administrimit me datë 22.09.2025 nga të gjithë anetareve të Tij

V E N D O S I:

1. Emërimin me komandim në pozicionin e Administratorit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" dhe nëpunës autorizues të znj. Eneida Vadohej.
2. Nëpunësi autorizues i komanduar i delegohen kompetencat për miratimin dhe realizimin e procedurave dhe shpenzimeve financiare si:
 - a) Shpenzimet për paga, kontribute, transferta tek individët (bursa, kompensime, ndihma të menjëherëshme në rast fatkeqësie).
 - b) Shpenzimet operative të domosdoshme siç janë faturat e energjisë elektrike, ujit të pishëm, shërbimit postar.
 - c) Shpenzime operative për ato procedura prokurimi tashmë në proces apo në përfundim e sipër.

- d) Shpenzime operative për ato kontrata në vazhdim siç janë :Shërbim i ruajtjes dhe sigurisë fizike; Materiale për blerje Kancelarie; Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore; Mbikëqyrje për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore ; Blerje paisje elektronike; Furnizim vendosje kondicionerësh; Projekti rikonstruksion çatia FshE (pjesa e dytë);Projektim Ndërtim i sistemit të kaldajave për ngrohjen e godinave të FshE ,FshSh dhe rektorat”;Sistemi dinamik(bileta udhetimi),Blerje“Gazoili”; Pajisje për Laboratorin Dozimetrik Sekondar për monitorimin e ekspozimit ndaj rrezatimit jonizues të stafëve mjeksore të Rajonit të Veriut; Pajisje për Fab-Lab i Universitetit për ekonominë qarkulluese dhe teknologjitë dixhitale të avancuara; Shpenzime siguracioni ndërtesash të Ush-së dhe Shpenzime të siguracioni të mjetit, e të tjera.

3. Nëpunësi autorizues ishte z.Admir Uruçi bëhet znj.Eneida Vadohej
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Bordit të Administrimit

Prof. Asoc.Dr. Adrian Leka

